



Npi – 01/309 datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenin 12, 24, dhe 40.2 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin, 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Qarkoren Buxhetore 2025/02 për Komuna; Propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.11/177 të datës 23.09.2024 për miratimin e Planit Buxhetor Komunal për vitin 2025; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 27.09.2024, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2025

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2024 të mbajtur më: 27.09.2024, me shumicën e votave miratoi Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2025, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në €
1	Pagat për vitin 2025 (me staf prej 738)	5,998,886
2	Mallra dhe Shërbime	1,502,000
3	Shpenzime Komunale	230,000
4	Subvencione dhe Transfere	500,000
5	Shpenzime Kapitale	2,546,294
Gjithsej Buxheti		10,777,180

II

Vendimi është aprovuar, pas procesit të diskutimit publik me qytetarë, me organizatat jo qeveritare, me subjektet politike, me grupet e interesit, si dhe duke marrë për bazë edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi